



Rr. Eduard Lir 158, Arbëria  
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: 038 22 22 55, 038 60 40 20  
Fax: 038 60 40 19  
Web: [www.tempulli.org](http://www.tempulli.org)  
Email: [info@tempulli.org](mailto:info@tempulli.org)

**MANUAL**

**PËR SIGURIMIN E CILËSISË**

**NË NIVEL INSTITUCIONAL**

**KOLEGJI TEMPULLI**

## **1. Hyrje dhe qëllimi i manualit**

Kolegji Tempulli e konsideron sigurimin e cilësisë si një proces themelor për zhvillimin akademik, institucional dhe shoqëror. Ky Manual është hartuar për të përshkruar në mënyrë të qartë, koherente dhe të strukturuar mënyrën se si funksionon sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë në Kolegj, si dhe për të udhëzuar të gjithë akterët e përfshirë në këtë proces.

Manuali synon të shërbejë jo vetëm si dokument formal, por edhe si udhëzues praktik për menaxhmentin, stafin akademik dhe administrativ, studentët dhe palët e interesit, duke sqaruar rolet, përgjegjësitë, procedurat dhe mekanizmat që sigurojnë përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë.

## **2. Baza ligjore dhe konteksti institucional**

Ky Manual është hartuar në përputhje të plotë me Statutin e Kolegjit Tempulli, Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë dhe Kalendarin Akademik të Sigurimit të Cilësisë. Ai reflekton kërkesat e Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, si dhe standardet dhe udhëzimet e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës dhe parimet e ESG/ENQA.

Në këtë kuptim, Manuali nuk krijon rregulla të reja, por operacionalizon dhe përshkruan mënyrën e zbatimit të rregullave ekzistuese, duke i bërë ato të kuptueshme dhe të zbatueshme në praktikën e përditshme institucionale.

## **3. Filozofia dhe parimet e sigurimit të cilësisë**

Sigurimi i cilësisë në Kolegjin Tempulli bazohet në filozofinë e përmirësimit të vazhdueshëm dhe në ndërtimin e një kulture institucionale të cilësisë. Cilësia nuk trajtohet si proces i izoluar apo formalitet administrativ, por si përgjegjësi e përbashkët e të gjithë akterëve të përfshirë në jetën akademike dhe institucionale.

Parimet themelore që udhëheqin këtë proces përfshijnë transparencën, llogaridhënien, përfshirjen aktive të studentëve dhe palëve të interesit, vendimmarrjen e bazuar në të dhëna dhe respektimin e autonomisë akademike. Këto parime reflektohen në të gjitha fazat e planifikimit, zbatimit, vlerësimit dhe përmirësimit të cilësisë.

#### **4. Fushat e Sigurimit të Cilësisë**

Sigurimi dhe vlerësimi i cilësisë në Kolegjin Tempulli realizohet në këto fusha:

- Strukturat organizative për sigurimin e cilësisë;
- Cilësia e Programeve studimore;
- Procesi arsimor;
- Puna arsimore dhe shkencore – hulumtuese;
- Resurset njerëzore (stafi akademik dhe jo akademik);
- Studentët;
- Tekstet, literatura, biblioteka, kabinetet e informatikës dhe laboratorët;
- Ambienti (hapësirat arsimore) dhe pajisjet;
- Përfshirja e studentëve në procesin e sigurimit dhe përparimit të cilësisë të punës;
- Alumni (të diplomuarit);
- Punëdhënësit.

#### **4. Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë**

Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë në Kolegjin Tempulli është i ndërtuar si sistem i integruar dhe funksionon në tri nivele të ndërlidhura: niveli institucional, niveli i programeve të studimit dhe niveli i moduleve/lëndëve. Kjo strukturë siguron që cilësia të monitorohet dhe të përmirësohet në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha aspektet e veprimtarisë së Kolegjit.

Procesi i sigurimit të cilësisë zhvillohet në mënyrë ciklike dhe përfshin fazat e planifikimit, zbatimit, vlerësimit, analizës dhe përmirësimit. Ky cikël siguron që rezultatet e vlerësimit të mos mbesin vetëm në nivel raportimi, por të shndërrohen në masa konkrete për përmirësim.

## **5. Struktura organizative dhe përgjegjësitë**

### **5.1. Roli i Këshillit Drejtues**

Këshilli Drejtues ka rol strategjik në sigurimin e cilësisë, duke integruar rekomandimet e dala nga proceset e vlerësimit në politikat zhvillimore dhe në planifikimin buxhetor të Kolegjit. Në këtë mënyrë, cilësia lidhet drejtpërdrejt me zhvillimin institucional dhe qëndrueshmërinë afatgjate.

### **5.2. Roli i Këshillit Akademik**

Këshilli Akademik është organi kryesor akademik përgjegjës për miratimin e rregulloreve të sigurimit të cilësisë, raporteve vjetore dhe planeve të përmirësimit. Ai siguron që proceset e sigurimit të cilësisë të jenë në përputhje me standardet akademike dhe misionin e Kolegjit.

### **5.3. Roli i Menaxhmentit**

Menaxhmenti i Kolegjit është përgjegjës për zbatimin praktik të politikave dhe procedurave të sigurimit të cilësisë. Ai koordinon proceset e vlerësimit, mbikëqyr zbatimin e masave të përmirësimit dhe siguron raportimin e rregullt në organet përkatëse.

### **5.4. Komisioni për Sigurimin e Cilësisë**

Komisioni për Sigurimin e Cilësisë përbën mekanizmin qendror operativ për mbikëqyrjen e cilësisë. Ai analizon rezultatet e vlerësimeve, miraton instrumentet dhe kalendarin e sigurimit të cilësisë, si dhe propozon rekomandime konkrete për përmirësim të cilësisë në nivel institucional dhe programor.

Komisioni për sigurimin e cilësisë siguron zbatimin e standardeve ndërkombëtare dhe standardeve të Agjencisë për Akreditim të Kosovës si dhe i propozon Këshillit Akademik rekomandime përkatëse. Komisioni i miraton kalendarin akademik për sigurim të cilësisë dhe instrumentet për vlerësimin e cilësisë. Komisioni i raporton Këshillit Akademik dhe poashtu promovon një kulturë cilësie në Akademi.

Komisioni për sigurimin e cilësisë përbëhet nga:

- 1.1 Nga një përfaqësues (staf akademik) prej secilit program të studimeve;
- 1.2 Një përfaqësues i studentëve;
- 1.3 Një përfaqësues nga administrata;
- 1.4 Drejtori i Akademisë (ex-officio)

Mandati i anëtarëve të komisionit për sigurim të cilësisë është i lidhur me mandatin e Këshillit Akademik.

Aktivitetet e komisionit për sigurim të cilësisë

- 1.1. Komisioni zbaton politikat dhe procedurat për sigurim të cilësisë në përputhje me statutin e Kolegjit, standardet ndërkombëtare dhe ato kombëtare.
- 1.2. Aprovon kalendarin e sigurimit të cilësisë;
- 1.3. Aprovon instrumentet vlerësuese.
- 1.4. Siguron zbatim efektiv dhe efikas të sigurimit të cilësisë në struktura akademike dhe administrative.
- 1.5. Mbështet ekipin punues në hartimin e RVV-ve në pajtim me Standardet e sigurimit të cilësisë.

### **5.5. Zyra e Sigurimit të Cilësisë**

Zyra e Sigurimit të Cilësisë është strukturë profesionale dhe teknike që mbështet të gjithë procesin e sigurimit të cilësisë. Ajo organizon proceset e vlerësimit, grumbullon dhe përpunon të dhënat, harton raporte analitike dhe siguron dokumentimin e plotë të procesit duke u mbështetur në Kalendarin për Sigurim të Cilësisë.

### **5.6. Komitetet e Programeve**

Në nivel të programeve të studimit, komitetet e programeve luajnë rol kyç në analizimin e rezultateve të vlerësimit, në monitorimin e mbarëvajtjes së procesit mësimor dhe në propozimin e ndryshimeve dhe përmirësimeve në përmbajtjen dhe strukturën e programeve.

## **6. Fushat e sigurimit dhe vlerësimit të cilësisë**

Sigurimi i cilësisë në Kolegjin Tempulli përfshin një gamë të gjerë fushash, duke përfshirë cilësinë e programeve të studimit, procesin e mësimdhënies dhe të nxënies, performancën e stafit akademik dhe administrativ, infrastrukturën dhe shërbimet mbështetëse, përfshirjen e studentëve, bashkëpunimin me alumni dhe punëdhënësit, si dhe ndikimin e Kolegjit në komunitet.

Kjo qasje gjithëpërfshirëse siguron që cilësia të vlerësohet jo vetëm në aspektin akademik, por edhe në dimensionin institucional dhe shoqëror.

## **7. Procesi i Vlerësimit dhe Përmirësimit të Cilësisë**

Monitorimi, vlerësimi dhe rishikimi i rregullt i programeve të studimit synojnë të sigurojnë që dispozita të mbetet e përshtatshme dhe të krijojë një mjedis mësimor mbështetës dhe efektiv për studentët.

Procesi i vlerësimit dhe përmirësimit të sigurimit të cilësisë përfshin vlerësimin e:

- 1.1 Programit;
- 1.2 Moduleve;
- 1.3 Infrastrukturës;
- 1.4 Mësimdhënësit.

## **8. Procesi i vlerësimit**

Procesi i vlerësimit të cilësisë realizohet përmes një kombinimi të instrumenteve sasiore dhe cilësore. Pyetësorët elektronikë për studentët, stafin akademik, alumni dhe punëdhënësit sigurojnë të dhëna të strukturuar dhe të matshme, ndërsa vlerësimi kolegjial, vetëvlerësimi dhe analizat narrative kontribuojnë në kuptimin më të thellë të rezultateve.

Të gjitha vlerësimet realizohen në mënyrë anonime dhe në përputhje me Kalendarin e Sigurimit të Cilësisë, duke garantuar besueshmëri dhe integritet të procesit.

Studentët janë të përfshirë në procesin e vlerësimit për sigurim të cilësisë. Bashkëpunimi midis Kolegjit dhe studentëve bëhet përmes Parlamentit Studentor. Studentët kanë përfaqësuesit e tyre në Komisionin e Sigurimit të Cilësisë. Të gjithë studentët e Kolegjit janë përfshirë direkt në vlerësimin e sigurimit të cilësisë së proceseve të Kolegjit përmes pyetësorëve të studentëve.

Studentët bëjnë vlerësimin në këto fusha:

- Pyetësi i vlerësimit të lëndës, mësimdhënësit dhe procesit të mësimdhënies në çdo semester;
- Pyetësi i vlerësimit të programit të studimit një herë në vit;
- Pyetësi i vlerësimit të infrastrukturës dhe shërbimeve për studentë.

### **Mësimi, mësimdhënia dhe vlerësimi i studentëve**

Vlerësimi i procesit të mësimdhënies nga studentët është inkorporuar në pyetësin e vlerësimit të stafit akademik dhe realizohet në përputhje me kalendarin e sigurimit të cilësisë.

Rezultatet e vlerësimit të procesit të mësimdhënies do të analizohen nga Koordinatori i programit përkatës dhe të gjeturat nga vlerësimi do të adresohen përmes planit zhvillimor të stafit akademik.

Çdo mësimdhënës ka të drejtë të shohë rezultatet e vlerësimit në lidhje me punën e tij/ saj. Ky informacion u jep mësimdhënësve feedback mbi punën e tyre.

### **Vlerësimi i mësimdhënësve dhe stafit administrativ**

Vlerësimi i mësimdhënësve bëhet nga studentët në çdo semester, nga kolegët dhe menaxhmenti.

Koordinatori i programit në fund të çdo viti akademik I dërgon secilit mësimdhënës raportet e vlerësimit nga studentët, nga vlerësimi kolegjial dhe raportin e vlerësimit nga menaxhmenti.

Koordinatori I programit gjithashtu përgatitë një raport të zhvillimit individual për secili mësimdhënës. Këto raporte i dërgon te Drejtori i Kolegjit i cili pas pranimit të këtyre dokumenteve nga të gjithë Koordinatorët e programeve, harton planin zhvillimor të stafit akademik.

### **Vlerësimi i infrastrukturës dhe shërbimeve mbështetëse**

Akademia në kuadër të pyetësorit për vlerësimin e programeve nga studentët, bënë edhe vlerësimin e infrastrukturës dhe burimeve mbështetëse. Të dhëna e grumbulluara përmes pyetësorëve, përpunohen nga zyra për sigurim të cilësisë dhe hartohet raporti, I cili i dërgohet Koordinatorit të programit dhe Drejtorit të Kolegjit, të cilët hartojnë planin e veprimit për përmirësimin e cilësisë.

Vlerësimi i infrastrukturës përfshin vlerësimin e: teksteve universitare, literaturës, bibliotekës, laboratoreve dhe kabineteve të informatikës.

### **9. Raportimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm**

Rezultatet e procesit të vlerësimit përmbliidhen në raporte që shërbejnë si bazë për hartimin e Planit të Përmirësimit të Cilësisë, i cili përfshin masa konkrete, afate dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë.

Në këtë mënyrë, sigurimi i cilësisë shndërrohet në proces dinamik që kontribuon drejtpërdrejt në zhvillimin dhe përmirësimin e Kolegjit.

Vlerësimet janë anonime dhe plotësohen në formë elektronike. Të dhënat grumbulluara nga pyetësorët përpunohen dhe hartohen raporte të cilat i dorëzohen Koordinatorit të programit përkatës, sekretarit si dhe menaxhmentit të Kolegjit si dhe publikohen në Platformën SEMS.

### **10. Hapat e aprovimit të një programi të ri studimi:**

- Inicimi i procesit për program të ri mund të vijë nga Stafit akademik, Industria/alumni, rekomandimet e eksperteve etj.;

- Kërkesa nga akterët e lartpërmendur paraqitet te Koordinatori i programit përkatësisht te komiteti i programit.
- Pas aprovimit të kërkesës nga ky organ, kërkesa procedohet për aprovim nga Këshilli Akademik;
- Këshilli Drejtues vlerëson arsyeshmërinë për aprovimin/mosaprovimin e programit të ri;
- Procesi për hartimin e programit vazhdon me formimin e ekipit për hartimin e programit i cili në konsultim me stafin akademik, alumni dhe bizneset, harmonizon programin e ri me nevojat e tregut;
- Këshilli Akademik aprovon planprogramet e reja të hartuara nga ekipi punues.

Hapat e hartimit/rishikimit të programeve ekzistuese gjatë procesit akreditimit është i njëjtë me procesin e hartimit të programeve të reja.

Programet ekzistuese mund të rishikohen në çdo kohë kur Kolegji e vlerëson se është I nevojshëm ky proces. Vlerësimi i nevojës për rishikim të programit mund të vijë nga raportet e vlerësimit të programit nga studentët, nga raportet e vlerësimit të akterëve të jashtëm përfshirë alumni dhe bizneset (hulumtim I cili realizohet një here në tre vite).

### **Paraqitja e moduleve të reja dhe ndryshimi i moduleve ekzistuese**

Në procesin e ndryshimit për përmirësimin e cilësisë, Kolegji ka të drejtë të shtojë dhe ndryshojë lëndë zgjedhore pa pasur nevojë të kaloj në procesin e akreditimit. Me qëllim të përmirësimit të cilësisë, ndryshimi i moduleve ekzistuese apo edhe të përfshirjes së moduleve të reja zgjedhore si rrjedhojë e rekomandimeve të vlerësimit, apo kërkesës së studentëve, stafit akademik, bizneseve etj.

Me këtë rast, Kolegji ndjek procedurat në vijim:

- Propozimet për një lëndë mund të vijnë nga iniciativa e studentëve, stafit akademik, komunitetit të biznesit, vendimi i menaxhmentit apo rekomandimi i vlerësuesit të jashtëm.
- Propozimi duhet të përfshijë syllabusin, vlerën e kredive, vitin në të cilin ofrohet, parakushtet për ndjekjen e modulit dhe ndikimet në planprogramin aktual.
- Kërkesa për lëndën e re zgjedhore i dërgohet Koordinatorit të programit përkatës, nëse moduli i propozuar është në harmoni me programin.

- Propozimet paraqiten në Komitet të programit, dhe propozimi dërgohet për miratim dhe në Këshill Akademik;
- Kolegji ka për obligim ta njoftoj AKA – në lidhur me ofrimin e lendes së re zgjedhore në programin përkatës.

## **12. Ndërlidhja me vlerësimin e jashtëm**

Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë është i ndërlidhur ngushtë me proceset e vlerësimit të jashtëm dhe akreditimit. Dokumentacioni dhe të dhënat e mbledhura përmes këtij sistemi shërbejnë si bazë për raportet e vetëvlerësimit dhe për bashkëpunimin me Agjencinë e Akreditimit të Kosovës.

## **11. Përfundim**

Ky Manual përfaqëson angazhimin e Kolegjit Tempulli për ndërtimin dhe ruajtjen e një sistemi të qëndrueshëm, transparent dhe efektiv të sigurimit të cilësisë. Përmes këtij sistemi, Kolegji synon të garantojë cilësi të lartë akademike, zhvillim institucional të qëndrueshëm dhe kontribut të vazhdueshëm në shoqëri.